



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë - Odeljenje za upravljanje javnim službenicima - Department for the Management of Public Officials

Nr. 01/2022

Data: 20.04.2022

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në pajtim me nenin 6 të Rregullores Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, merr këtë:

V E N D I M

I. Anullohet procedura e rekrutimit për pozitën, Drejtor i përgjithshëm në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë - Zyra e Kryeministrit të Kosovës me Nr. Referencës RN00007680 i publikuar me datë 30.09.2021.

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka publikuar procedurën e rekrutimit për pozitën, Drejtor i përgjithshëm në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në kuadër të Zyra e Kryeministrit të Kosovës me Nr. Referencës RN00007680 i publikuar me datë 30.09.2021.

Në pamundësi të vazhimit për kryerjen e vlerësimin profesional nga Komisioni Shtetëror i Pranimin për arsye se dy anëtarëve të këtij Komisioni ju ka kaluar mandati si nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues dhe në pajtim me dispozitat ligjore nuk kanë të drejtë të jenë më anëtarë të këtij Komisioni, dhe po ashtu në pamundësi për të plotësuar komisionin shtetëror të pranimin me anëtarë sipas kriterëve të nenit 9 të Rregullores Nr.15/2020 për pranimin, vlerësimin dhe disiplinën e nëpunësve të lartë drejtues, është bërë tejkalimi i afateve ligjore sipas Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative për përfundimin e procedurës të rekrutimit për pozitën Drejtor i përgjithshëm në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë - Zyra e Kryeministrit të Kosovës.

Andaj nga kjo që u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Shehrie Lec

Zv. Drejtor

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik

